



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. 2-D/DPK	Bi Prot. 01-4592/14
Dep.	Prot. No.
Nr. flet.	Data
Broj shënime	Datum
Nr. pages	Date
02	04.12.2014
CHITINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 03.12.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-3759/14, për, z. Bajram Shaqiri, Kryeshef i Departamentit ne Ministrinë e Shëndetësisë, për shkak se zyrtari publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-3759/14, qe për trajtim ka pasur zyrtarin z. Bajram Shaqiri, Kryeshef Departamenti ne Ministrin e Shëndetësisë.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari z. Bajram Shaqiri gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si Kryeshef i Departamentit, është duke ushtruar aktivitet në veprimtari private si pronar dhe person i autorizuar, në një biznes privat e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin te funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 31.10.2014, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Bajram Shaqiri është përgjigjur shkresës paralajmëruese duke ardhur ne AKK, me datën 12.11.2014 ku është njoftuar nga zyrtaret e AKK-së, për faktet qe disponon Agjencia lidhur me dyshimin për Konflikt të mundshëm të interesit.

z. Bajram Shaqiri, gjatë takimit është pajtuar me gjendjen, dhe është zotuar se në afat sa me të shpejt do të veproj sipas rekomandimeve të Agjencisë dhe do të bëj ndryshimet e nevojshme dhe do të shmanget nga situata e mundshme e konfliktit të interesit.

Me datën 25.11.2014, z. Bajram Shaqiri, ka sjell në AKK-ë dokumentet zyrtare të lëshuar nga ARBK-ja ku dëshmohet se janë bërë ndryshimet e kërkuara sipas ligjit në fuqi dhe se në biznesin me nr. 70021240 dhe me emër N.SH. Ordinanca Speciali stike Otorinolaringologjike "Orl Med" – z. Bajram Shaqiri, nuk figuron si person i autorizuar, pasi që ka autorizuar një person tjetër, si person të besuar në këtë biznes.

Vlerësojmë se zyrtari i lartë publik z. Bajram Shaqiri, me ndryshimet e bëra në biznes ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

